

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës-Departamenti për krime të rënda, në kolegji të përbërë nga gjyqtarët: Tore Thomassen, kryetar, Fillim Skoro, gjyqtar raportues e Vahid Halili, anëtar, me zyrtaren ligjore, Anna Malmstrom, në lëndën penale kundër të akuzuarit **MK**, nga fshati për shkak të veprave penale të vrasjes së rëndë nga neni 147 par.1 nën par.4, të lëndimit të rëndë trupor nga neni 154 par.1 nën par.3 dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose në shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KP të Kosovës, duke vendosur përkitazi me ankesën e Zyrës së prokurorëve të EULEX-it, në Pejë, dhe të mbrojtësit të akuzuarit **MK**, avokatit Muharrem Hoti, dhe të përgjigjeve në ankesë të mbrojtësve të akuzuarit, avokatëve Haxhi Millakut, Muharrem Hoti, si dhe të sqarimit me shkrim të Zyrës së kryeprokurorit të shtetit, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, P.nr.336/2010, të dt.22.08.2011, në seancën e Kolegjit të mbajtur në praninë e të akuzuarit, dhe mbrojtësit të tij, të dëmtuarit **LP**, të cilin e përfaqëson avokati Zeqir Berdynaj, e në mungesë të prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit të akuzuarit, avokatit Muharrem Hoti, me dt. 18.06.2013, morri këtë:

AKTGJYKIM

Refuzohen ankesat e Zyrës së prokurorit të EULEX-it, në Pejë, dhe mbrojtësit të akuzuarit **MK**, avokatit Muharrem Hoti, dhe aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë, P.nr.336/2010, të dt.22.08.2011, vërtetohet.

Arsyetim

Me aktgjykimin e sulmuar të Gjykatës së Qarkut në Pejë, 336/2010, të dt.22.08.2011, i akuzuari **MK**, është shpallur fajtor për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll posedim ose në shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KP të Kosovës, dhe i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 1(një)viti, e në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt.03.03.2010, deri me dt. 22.08.2011, nga i akuzuari është konfiskuar edhe revolva e markës "TT", nr. , së bashku me karikatorin dhe 8 fishek të kal.7.62mm, si mjet i kryerjes së veprës penale dhe është urdhëruar shkatërrimi i të njëjtës, si dhe i akuzuari është obliguar që për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor të paguajë shumën prej 100Euro, si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 80Euro, e të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

Me aktgjykimin e njëjtë gjykata e shkallës së parë, të akuzuarin **MK**, në pajtim me dispozitat e nenit 390 par.3 të KPP të Kosovës, për veprat penale të vrasjes së rëndë nga neni 147 par.1 nën par.4, të lëndimit të rëndë trupor nga neni 154 par.1 nën par.3 të KP të Kosovës, e ka liruar nga akuza, për shkak se nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprat penale, e të cilat kanë qenë objekt i akuzës.

Kundër këtij, aktgjykimi me kohë kanë ushtruar ankesë:

Zyra e Prokurorisë së Qarkut-Prokurorët e EULEX-it, në regjionin e Pejës, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që gjykata e shkallës së dytë, aktgjykimin e sulmuar ta ndryshoj dhe të gjejë se i akuzuari është fajtor për veprat penale të vrasjes së rëndë, nga neni 147 par.1 nën par.4, të lëndimit të rëndë trupor nga neni 154 par.1 nën par.3 të KP të Kosovës, ose që çështjen penale ta anuloj dhe lëndën ta kthejë në rigjykim.

Mbrojtësi i të akuzuarit **MK**, avokati Muharrem Hoti, për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që gjykata e shkallës së dytë, aktgjykimin e sulmuar ta ndryshoj dhe të mbrojturit të tij, të akuzuarit të ia shqiptoj dënimin alternativ, dënimin me kusht.

Përgjigje në ankesë, ka ushtruar mbrojtësi i të akuzuarit, Haxhi Millaku i cili ka propozuar që ankesa e PPS në Pejë, të refuzohet si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, të vërtetohet.

Përgjigje në ankesë ka ushtruar edhe mbrojtësi i të akuzuarit, Muharrem Hoti, i cili ka propozuar që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, të vërtetohet vetëm në pjesën e sulmuar, nga ana e Prokurores Publike në Pejë.

Prokuroria e shtetit, me shkresën e saj, AP.nr.2/12, te dt.25.01.2012, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e Prokurorisë së EULEX-it, dhe të mbrojtësit të akuzuarit, ka propozuar që gjykata e shkallës së dytë, në tërësi të refuzoj ankesën e prokurorit, ndërsa të aprovoj ankesën e mbrojtësit, duke propozuar që të akuzuarit të i shqiptohet një dënim që të merr parasysht qëllimin e dënimit, si dhe rrethanat rënduese dhe lehtësuese, e duke u bazuar në shkallën e përgjegjësisë penale juridike të akuzuarit.

Sipas kompetencës funksionale, e në bazë të vendimit të kryetarit të asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-t, me numër 2013.OPEJ.0238.001, ku në çështjen e të akuzuarit **MK**, do të vendos kolegji i Gjykatës së Apelit, në përbërje prej gjyqtarit të EULEX-it, si kryetar i kolegjit dhe dy gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit - si anëtarë të kolegjit, e në bazë të ligjit 03/L53, Gjykata e Apelit, në pajtim me dispozitën e nenit 410 par.1 të KPP të Kosovës, caktoi seancën e kolegjit.

Në seancën e kolegjit mori pjesë i akuzuari **MK**, dhe mbrojtësi i të akuzuarit, av.Haxhi Millaku, i cili në seancë sqaroi disa prej pretendimeve të paraqitura në përgjigjen e tij në ankesë, me të cilat është pajtuar në tërësi edhe i akuzuari, dhe i njëjti është pajtuar edhe me pretendimet të paraqitura në ankesë të mbrojtësit të tij, av.Muharrem Hoti, si dhe pretendimet e paraqitura në ankesën e mbrojtësit të tij Muharrem Hoti, për shkak të vendimit për dënimin.

Në seancën e kolegjit mori pjesë i dëmtuari **LP**, dhe përfaqësuesi i palës së dëmtuar, av.Zeqir Berdynaj, i cili në tërësi e përkrahu ankesën e Prokurorit të EULEX-it, dhe sqaroi disa prej pretendimeve nga ankesa, dhe në shqyrtimet gjyqësore të mbajtura, e me të cilat është pajtuar edhe i dëmtuari.

Seanca e kolegjit, është mbajtur në mungesë të prokurorit të shtetit dhe të mbrojtësit të akuzuarit, av.Muharrem Hoti, edhe pse ata ishin njoftuar në mënyrë të rregullt dhe seanca e

kolegjit është mbajtur pa pjesëmarrjen e në pajtim me dispozitën e nenit 390 par.4 të KPP të Kosovës.

Gjykata e Apelit, e në pajtim të nenit 415 par.1 të KPP të Kosovës, shqyrtoi ankesën e Prokurorisë së EULEX-it, të mbrojtësit të akuzuarit, si dhe të sqarimit me shkrim të Prokurorit të Shtetit, vlerësoi edhe shkresat tjera të lëndës dhe gjeti se:

Ankesat e Prokurorit të EULEX-it, në Pejë dhe mbrojtësit të akuzuarit, **MK**, janë të pa bazuara.

Gjykata e Apelit, duke marrë parasysh që me ankesën e Prokurorit të EULEX-it, nuk sulmohet aktgjykimi për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, e në pajtim me dispozitën e nenit 403 par.1 të KPP të Kosovës, e sipas detyrës zyrtare, vlerësoi edhe këto pretendime ankimore edhe pse nuk janë të paraqitura në ankesa, dhe gjeti se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk është përfshirë në shkeljet e lartë cekura, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

Pretendimet ankimore të paraqitura në ankesën e Prokurorisë se gjykata e shkallës së parë, se ka shmangur plotësisht çdo vlerësim të dëshmitarëve **LP**, **GP** dhe **FP** të dhënë para trupit gjykues, e duke u bazuar në deklaratat e tyre të dhëna në polici dhe në shqyrtimin gjyqësor kur ishin dëgjuar, si dhe nuk është vlerësuar foto albumi i identifikimit të kryesit të mundshëm të veprës penale, edhe pse të tre dëshmitarët në shqyrtimet gjyqësore si dëshmitar okular, kanë shprehur sinqeritet në deklaratat e tyre, e të cilat lehtësisht ndryshojnë, e në lidhje me kryesin e veprës penale.

Po ashtu ankesa pretendon se gjykata e shkallës së parë, është thirrur me përqindje, e i cili konkludim i gjykatës së shkallës së parë, është retorik, dhe gjykata e shkallës së parë, gjatë dëgjimit të dëshmitarëve, nuk i ka sqaruar çështjet dhe të njëjtat kanë mbetur të pa sqaruara dhe se nga deklaratat e dëshmitarëve **LP** e **GP**, nuk vihet në dyshim kryesi i veprës.

Gjykata e shkallës së parë, edhe përkundër këtyre fakteve të akuzuarin e ka liruar nga akuza për dy veprat penale e më afër të përshkruara në pjesën liruese të aktgjykimit. Sipas ankesës konkludimi i gjykatës së shkallës së parë lidhur me vlerësimin e identifikimit të bërë në polici nga ana e dëshmitarëve nuk është i drejtë, nga se edhe pse fotoalbumi nuk është më ideali dëshmitarët kanë identifikuar kryesin nga fytyra e tij dhe ankesa pretendon se fare nuk kanë rëndësi shenjat tjera dalluese, e në të cilat bazohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë.

Po ashtu ankesa pretendon se vlerësimi i gjykatës së shkallës së parë, se i akuzuari menjëherë ka shkuar në spital, është vlerësim dhe konkludim i gabuar i gjykatës së shkallës së parë, e sipas ankesës kjo nga fakti se i akuzuari e ka ditur se e kanë vërejtur tre fëmijë dhe vetëm ata mund ta njihnin, dhe se i akuzuari e ka ditur se njeri prej tyre është i plagosur dhe se ka qenë në operacion dhe nga kjo rrjedh se i akuzuari e ka pas të qartë se nuk ka mundur të takohej me askënd në spital dhe të identifikohet atë.

Sipas qëndrimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet e paraqitura të prokurorit janë të pa bazuara nga fakti se nga provat e nxjerra në shqyrtimin gjyqësor e sidomos nga provat bazike, e që kemi të bëjmë me identifikimin e kryesit të veprës penale – bëhet fjalë për të akuzuarin **MK**, e i

cili identifikim është bërë nga foto albumi nga fotografit 1 gjer në 7, dhe se dëshmitarët **LP**, **GP** dhe **FP**, kanë identifikuar fotografin nr.3, mirëpo asnjeri nuk ka qenë i sigurt se i akuzuari **MK**, është kryes i veprës penale, dhe dëshmitarët e njëjtë nuk kanë mund të i përshkruajnë edhe karakteristikat tjera dalluese të kryesit të veprës penale në bazë të identifikimit.

Nga deponimi i dëshmitarit **LA** i cili sipas shkrësave të lëndës në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se i akuzuari **MK** ka qenë në ceremoninë e martesës me 31.12.2009 e cila sipas akuzës është dita kur është privuar nga jeta i ndjeri **DP**, rrjedh konkludimi i qartë se i akuzuari në të njëjtën kohë nuk ka mund të jetë në dy vende, se i akuzuari **MK** e ka njohur të ndjerin **DP**, dhe ai nuk ka pas asnjë mosmarrëveshje me të akuzuarin, dhe të njëjtin fakt në shqyrtimin gjyqësor e vërtetojnë dëshmitarët **MP** dhe **PP**.

Sipas qëndrimit të gjykatës së shkallës së parë, nga ato që u cekën më lartë se i akuzuari nuk ka pas raporte të këqija dhe mosmarrëveshje me të ndjerin pasi që ka dëgjuar për rastin i akuzuari menjëherë ka shkuar në spital për të u interesuar, dhe gjykata e shkallës së parë ka ardhur në përfundim se i akuzuari po të ishte kryes i veprës penale nuk kishte për të shkuar në spital, por do të vepronte në ndonjë mënyrë tjetër.

Gjykata e shkallës së parë, nga dëshmitarët okular **LP**, **FP** dhe **GP** të cilët tri javë pas ngjarjes së ndodhur lidhur me privimin nga jeta të ndjerit **DP**, atyre iu janë treguar fotografit e shtatë personave, prej numrit 1, deri në numrin 7, dhe të tre dëshmitarët e kanë identifikuar nga foto albumi, fotografinë me nr.3, mirëpo, asnjeri prej këtyre nuk ka qenë i sigurt se personi i identifikuar me numrin 3, nga fotoalbumi, është kryes i veprës penale. Përveç kësaj, dëshmitarët e përmendur më lartë, nuk kanë treguar shenja tjera dalluese ose të njëjtat shenja dalluese, të cilat i kanë treguar ato, nuk përputhen me njëra tjetrën, e për identifikimin e kryesit të veprës penale. Përveç kësaj gjykata e shkallës së parë, nuk ka gjetur dhe dëshmi tjera teknike si prova materiale për të mbështetur faktin se i akuzuari **MK**, është kryes i veprës penale, dhe sipas gjykatës së shkallës së parë, nuk ka ekzistuar asnjë motiv që i akuzuari për ndonjë arsye apo shkak të mëhershëm do ta shtynte atë që ta privoj nga jeta të ndjerin **DP**.

Duke u nisur nga ajo se i akuzuari ditën kritike ka qenë në ceremoninë e martesës në shtëpinë e **LA**, dhe se i akuzuari njëkohësisht nuk ka mundur të jetë me dt.31.12.2009, në dy vende, dhe menjëherë pasi që ka ndodhur ngjarja, i akuzuari ka shkuar në spital kjo sipas gjykatës së shkallës së parë, tregon se nuk do të ishte e mundur që i akuzuari të ndërmerr atë veprim po të ishte kryes i veprës penale ndaj të ndjerit. Duke u nisur nga të cekurat më lart lidhur me konkludimet e gjykatës së shkallës së parë, e me të cilën i akuzuari **MK**, është liruar nga akuza për veprën penale të vrasjes së rëndë, nga neni 147 par.1 nën par.4 dhe veprës penale të lëndimit të rëndë trupor nga neni 154 par.1 nën par.3 të KP të Kosovës, gjykata e shkallës së parë, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila është e pranueshme në tërësi edhe për këtë gjykatë.

Gjykata e Apelit duke i vlerësuar aktgjykimin e sulmuar përkitazi me vendimin mbi dënimin, të mbrojtësit të akuzuarit, se gjykata e shkallës së parë, nuk ka vlerësuar rrethanat lehtësuese se i akuzuari ka pranuar fajin, se është penduarës ka premtuar se nuk do të bie ndesh me ligjin, se është familjar dhe babë i pesë fëmijëve të mitur-anëtar ushqyes i vetëm i familjes, se bashkëshortja e tij nuk realizon të ardhura, se i akuzuari nuk ka pasuri të pa luajtshme dhe me familje jeton tek familjarët e vet ngase nuk ka shtëpi të veten, se arma e cila është konfiskuar në shtëpinë e tij tregon se i akuzuari atë e ka mbajtur vetëm për nevoja preventive dhe se e njëjta nuk është përdorur për ndonjë krim të mundshëm, e si pasojë e mos vlerësimit të duhur të këtyre rrethanave gjykata e shkallës së parë të akuzuarit **MK**, i ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti.

Sipas qëndrimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet e cekura më lartë të mbrojtësit të akuzuarit nuk qëndrojnë. Gjykata e shkallës së parë, gjatë matjes së dënimit ka vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese e të parapara si në dispozitën e nenit 64 të KPP të Kosovës, dhe ka vlerësuar dy rrethana të rëndësishme që dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit ka për qëllim për të parandaluar të akuzuarin dhe kryesit e tjerë që të kryejnë akte të ngjashme dhe se në këto

rrethana këto vepra penale kanë rrezikshmëri të zmadhuar shoqërore, e në kuadër të këtyre rrethanave gjykata e shkallës së parë, ka vlerësuar edhe rrethanat në të cilat pretendon ankesa e mbrojtësit të akuzuarit, e të cilat hyjnë në kuadër të dy rrethanave të rëndësishme të asaj mbi qëllimin e dënimit dhe parandalimin e kryesve të veprave penale dhe duke marrë parasysh dënimin, i cili është paraparë për këtë vepër penale, gjykata e shkallës së parë, të akuzuarit ia ka shqiptuar minimumin e paraparë ligjor me burgim prej 1(një)viti, i cili dënim i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë, është i pranueshëm edhe për Gjykatën e Apelit.

Sipas qëndrimit të Gjykatës së Apelit, dënimi i këtillë i shqiptuar në tërësi i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë penale intensitetit të rrezikimit, dhe dënimi i këtillë i shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, është në proporcion me veprën penale të kryer, dhe është i pranueshëm edhe për Gjykatën e Apelit, për shkak se gjykata e shkallës së parë, ka vlerësuar dy rrethana rënduese dhe përcaktuese me rastin e matjes së dënimit dhe shqiptimit të saj. Dënimi i këtillë i shqiptuar i shërben edhe preventivës individuale dhe gjenerale dhe në tërësi pritët të arrihet edhe qëllimi i ndëshkimit të paraparë si në nenin 34 të KPP të Kosovës.

Nga se u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në pajtim të nenit 423 të KPP të Kosovës.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.902/2012 me 18.06.2013

Zyrtarja ligjore,

Anna Malmstrom,

Anëtarët e Kolegjit

Fillim Skoro

Vahid Halili

Kryetari i Kolegjit

Tore Thomassen,